

# Arsimimi

## KULTURA E NJERIUT



*E-bulletin*

Tetor, 2018

Një takim i rëndësishëm i SBASHK-ut në ambientet e Qeverisë së Kosovës



### Limaj i jep mbështetje të plotë angazhimeve të SBASHK –ut

Me qëllim të nxitjes për angazhime të shtuara të Ministrit Bytyqi, veçmas lidhur me Projektligjin e pagave dhe atë për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, por edhe për shtimin e bashkëpunimit dhe komunikimit për yshje me rëndësi, SBASHK-u i ishte drejtuar kabinetit të Zv/kryeministrit Fatmir Limaj për një takim me të dhe me Ministrin e MASHT. ...(faqe 5)

**SBASHK-u në një ngjarje e vecantë për arsimin shqiptar**

Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë ka mbajtur Kongresin e e 7-të pë të bërë....(faqe 10)



Fehmiu është kryetar i shoqatës sindikale në Fakultetin e Edukimit dhe është shumë aktiv në kuadër të SUSHK-ut, gjegjësisht SBASHK-ut (faqe 3).

### SBASHK për Ditën Ndërkombëtare të Mësuesit



Mësuesit dhe arsimi në tërësi kudo në botë para sfidave të shumta

Me një konferencë për mediet dhe me aktivitete të shumta nëpër shkollat e Kosovës ...(faqe 6)

### Vazhdojnë aktivitetet dhe bashkëbisedat me anëtarësinë



### Interesim i shtuar për trajnimet e licencuara të SBASHK-ut

Në shumë nga komunat e Kosovës është duke vazhduar gjatë vikendeve trajnimi për forcimin e kapaciteteve për dialogun social... (faqe 8)

## Editorial

### Fatet e ngjashme të mësuesve kudo në botë



Me të ardhur tatori sindikatat e arsimit kudo në botë organizojnë aktivitete në shenjë respekti për 5 titorin Ditën Botërore të Mësuesit. Aktivitetet organizohen në bashkërenditje me Internacionalen Botërore të Arsimit (EI) dhe me Komitetin e Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE). Ajo që bie në sy, jo vetëm nga debatet në kuadër të shënimit të kësaj date të rëndësishme, por edhe në Konferanca ndërkombëtare të arsimit, është se janë të ngjashme fatet e mësuesve kudo nëpër botë. Institucionet shtetërore dhe disa individë anë e kënd Ballkanit, Evropës e besa edhe anë e kënd botës kanë shtuar angazhimet e

përpjekjet për ta mbajtur nën presion mësuesin, për t'i hequr autonominë e punës intelektuale, për t'i servuar plane e kurrikula pa e pyetur shumë mësuesin. Janë shtuar përpjekjet që të zverdhet personaliteti i mësuesit dhe vlera e punës dhe misionit të tij të shenjtë.

Kështu është edhe në Kosovë njerëz, edhe nga institucionet, që nuk kanë punuar as edhe një javë në profesionin e mësuesit, dalin e flasin keq e pa as një fakt për punën e shenjtë të mësuesit duke dhënë vlerësime paushall se gjoja punëtorët e arsimit nuk punuan sa duhet dhe se gjoja cilësia e arsimit është e dobët. Duke u gjendur në një situatë të tillë sindikatat e arsimit nga e tërë Evropa në takime e Konferanca kanë ngritur alarmin dhe janë mobilizuar fuqishëm që bashkërisht të angazhohen duke u solidarizuar, si gjithmonë, në mbrojtje të personalitetit të mësuesit.

Ne do ta mbrojmë me arsyesh dhe bashkërisht personalitetin e mësuesit sepse ai kryen njërin nga misionet më të shenjta për njerëzimin. Mësuesit e mbrojnë dritën dhe e mposhtin errësirën.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të viziton ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos heziton të na jepni sygjerime përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektonike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rrëth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)**

përfaqëson rrëth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit International (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

Intervistë me kryetarin e sindikatës në Fakultetin e Edukimit , Fehmi Ramadani

### SBASHK-u ka shënuar arritje të mëdha, por na presin ende punë e angazhime



Fehmu është kryetar i shoqatës sindikale në Fakultetin e Edukimit dhe është shumë aktiv në kuadër të SUSHK-ut, gjegjësisht SBASHK-ut. "Profesioni mësimdhënës është një ndër profesionet më të shenja, në duart e të cilit kalojnë gjenerata të tëra, ata janë edukatorë, mësues profesorë, por edhe si prindër të dytë për secilin nxënës", shprehet Fehmu në intervistën për gazeten tonë, i pyetur për profesionin e mësuesit.

Arsimimi sot: **Kush është Fehmi Ramadani?**

**Fehmu:** Kam lindur në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme e kam mbaruar ne Mitrovicë. Më pastaj kam mbaruar studimet ne Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Edukimit, dega Fizikë-Kimi, pastaj kam vazhduar me studimet për të arritur te titulli master i shkencave natyrore, në Universitetin e Prishtinës. Jam i martuar me Arietën dhe kamë dy vajza Rigën dhe Tanën. Punoj në Fakultetin e Edukimit pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" si asistent-laborant i shkencave natyrore, përfaqësues i administratës pranë Këshillit të Fakultetit të Edukimit që dy mandate, kryetar i njësisë sindikale të Fakultetit të Edukimit nga viti i kaluar 2017.

Arsimimi sot: **Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot ?**

**Fehmu:** Profesioni mësimdhënës është një ndër profesionet më të shenja, në duart e të cilit kalojnë gjenerata të tëra, ata janë edukatorë, mësues profesorë, por edhe si prindër të dytë për secilin nxënës. Megjithatë, se sa është I vështirë dhe sa vlerësohet ky profesion në ditët e sotme, është shumë diskutabile. Profesioni i mësimdhënësit është një ndër profesionet më të shenja, më të vlerësuara dhe më të respektuara në të gjithë botën, mirëpo tek ne ende nuk e ka atë vlerë, do të thotë nuk vlerësohet aq sa duhet edhe pse kanë në dorë breza të ardhshëm që të arsimohen .

Vështirësitet që paraqiten të mësimdhënësi sot janë:

- Mos realizimi i kërkesave elementare nga Institucionet relevante siç janë: Qeveria, MASHT-I, UNIVERSITETET dhe institucionet tjera.
- Krijimi i kushteve më të mira për punë , pra MASHT-it e cila tash e sa vite nuk ka krijuar kushtet nëpër shkolla siç janë: mjetet e konkretizimit , laboratorët, pajisjet teknologjike të cilat ndikojnë drejtësuarët në rezultatet e të nxënët të nxënësve, suksesin e tyre në shkollë ashtu edhe ne testet e ndryshme siç është PISSA dhe testet tjera.
- Mos realizimi i kontratës kolektive (Pagat janë minimale në krahasim me institucionet qeveritare dhe punën që e bëjnë ata sidomos me ligjin e ri për pagat).

Arsimimi sot: **Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut ?**

**Fehmu:** Me theks të veçantë do veçoja kthimin e besimit të anëtarësisë dhe gjithë të punësuarve në arsimin e Kosovës në SBASHK, i cili duhet të bëhet edhe ne Universitet besim në konteste te caktuara kohore ishte i luhatur.

- Arritje shumë e madhe është Kontrata kolektive
- Pjesëmarja ne hartimin e ligjeve dhe avokimi i kërkesave të mësimdhënësve .

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

- Ndërkombëtarizimi i SBASHK-ut pjesëmarrja në konferenca të ndryshme
- Anëtarësimi i SBASHK-ut në Unionin e Sindikatave të Arsimit të Evropës
- Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve në shërbim të anëtarësisë.
- Akreditimi i programeve për trajnime

Arsimimi sot:

**Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta ?**

**Fehmiu:**

- Ristrukturim dhe angazhim rrëth çështjeve ne universitetet të Kosovës
- Mbrojtja e dinjitetit të mësimdhënësve, përfshirë këtu pozitën materiale dhe krijimin e kushteve më të mira në punë, angazhimin maksimal për të arritur dhe aprovuar ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta, dhe zbatimin e Kontratës Kolektive në përgjithësi.

Arsimimi sot: **Si ndiheni si kryetar i Shoqatës se Sindikatës për Fakultetin e Edukimit?**

**Fehmiu:** Si kryetar i Shoqatës Sindikale të Fakultetit të Edukimit ndihem shumë i nderuar dhe respektuar nga stafi akademik dhe administrativ i njësisë Akademike të cilët i falënderoj publikisht.

- Ajo që nuk më bënë të ndjehem mirë është mos realizimi i kërkesave të shumta që kemi drejtuar Universitetit dhe MASHT-it për probleme të ndryshme që kanë anëtarësia e sindikatës sidomos stafit administrativ.
- Edhe përkundër shumë premtiveve nga Universiteti i Prishtinës, ende nuk është dhënë pjesa prej 0.5 % për çdo vit shërbimi në pjesën stimulative.
- Mos zbatimi i kontratës kolektive,
- Mos realizimi i kërkesës së sindikatës për pagesën e 30% edhe pse me vendimi i Gjykatës Themelore është në favor tonin, por Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe tash realizimi i kësaj kërkesë shtyhet ndoshta për vite.

Arsimimi sot: **Çka te shtyri te angazhohesh si kryetar i Sindikatës?**

**Fehmiu:** Duke parë mos realizimin e shumë kërkesave të SUSHK-ut u angazhova që të japë kontributin tim sado të vogël në realizimin e kërkesave elementare të punëtoreve të Fakultetit të Edukimit në veçanti dhe Universitetit në përgjithësi sidomos të punëtorëve administrativ po e ceku këtë sepse janë më të shkelurit në krahasim me institucionet tjera qeveritare si në ligjin për paga po ashtu edhe në punën dhe angazhimin e tyre që e bëjnë.

Arsimimi sot: **Çka do të veçonit nga puna e juaj ?**

**Fehmiu:**

- Adresimi i kërkesave të anëtarësisë drejtuar SBASHK-ut, Universitetit, MASHT-it, Komisioneve Parlamentare për Arsim etj.
- Vënia e kontakteve të bashkëpunimit me Sindikatat rajonale si Shqipërisë, Maqedonisë, Turqisë dhe Sllovenisë.
- Organizimi i grevës me vendim të takimit të jashtëzakonshëm të KD-së së SBASHK-ut të mbajtur me datë: 10.02.2018 për realizim e kërkesë për mësimdhënësit e viteve të 90-ta.
- Përfaqësimi i shoqatës sindikale të Fakultetit të Edukimit nga anëtari Atdhe Hykollit në konferencë rajonale dhe ndërkombëtare.
- Pjesëmarrja në trajnimin për dialogun sociale të organizuar nga SBASHK, si dhe organizime dhe aktivitet tjera sindikale.

Arsimimi sot: **A keni diçka për të shtuar ?**

**Fehmiu:** I ftojë që të gjithë së bashku duke filluar nga Shoqata Sindikale e Fakulteteve, Universitetet dhe SBASHK-ut të angazhohemi në mbrojtjen dhe realizimin e kërkesave të anëtarësisë sonë të cilat kërkesa me vite të tëra rrinë pa u shqyrtau fare apo edhe ato që shqyrtohen janë negative e të cilat janë më së të realizueshme por pa vullnetin e mirë të institucioneve përkatëse nuk mund të zgjidhen.


**Na prift e mbara në punë!**



## Gjatë muajit

Një takim i rëndësishëm i SBASHK-ut në ambientet e Qeverisë së Kosovës

### Limaj i jep mbështetje të plotë angazhimeve të SBASHK –ut



Me qëllim të nxitjes për angazhime të shtuara të Ministrit Bytyqi, veçmas lidhur me Projektligjin e pagave dhe atë për statusin e punëtorëve të arsimt shqip të Republikës së Kosovës, por edhe për shtimin e bashkëpunimit dhe komunikimit për çështje me rëndësi, SBASHK-u i ishte drejtuar kabinetit të Zv/Kryeministrit Fatmir Limaj për një takim me të dhe me Ministrin e MASHT. Ky takim është mbajtur në ambientet e Qeverisë së Kosovës dhe SBASHK-un e kanë përfaqësuar nga kryetari, Rahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.

Në hapje të takimit Zv/Kryeministri Limaj është shprehur se çmon lart angazhimin e SBASHK-ut në realizimin e kërkesave legititime të anëtarësisë dhe në përkushtimin për ngritjen e vazdueshme të cilësisë në arsim. Ai ka apeluar të përfaqësuesit e SBASHK-ut që të flasin për gjithë çështjet që i preokupojnë.

Kryetari i SBASHK-ut bashkë me menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm kanë ngritur këto shqetësimë:

1. Mungesa e takimeve me Drejtoret e Drejtoreve Arsimore, pjesë e të cilave takime ka qenë edhe SBASHK dhe dikur janë mbajtur çdo muaj për t'u debatuar të gjitha çështjet aktuale. Ka muaj që takime të tilla nuk janë mbajtur.
2. Mungesa e gatishmërisë së Ministrit për takime me ne edhe pse vazhdimisht i kemi dërguar shkresa me kërkesën për t'u takuar.

3. As një herë nuk është mbrojtur në Komisionin Parlamentar për Arsim nga Ministri Ligji për statusin e punëtorëve të arsimt shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta. Madje shpesh në takimet e këtij Komisioni kur është debatuar për këtë projektligj nuk ka qenë askush nga MASHT dhe anëtarja e këtij Komisioni nga NISMA është ndier keq kur të tjerët anëtarë e kanë shtruar pyetjen pse po mungon MASHT.
4. Ligji i pagave- radhitja e 85 % e të punësuarve në arsim më e ulët se e vozitësve të udhëheqësve. Ministri nuk ka bërë ndonjë angazhim të veçantë që të përmirësohet kjo radhitje degraduese dhe që punëtorët e arsimt tē jenë në vend meritor.
5. Nuk funksionon Komisioni Këshillëdhënës për Arsim Parauniversitar dhe ai për arsimin profesional. ( tē dy këto komisione të parapara me Ligj.
6. Mbështetja e fuqishme dhe publike e Ministrit ndaj Rrjetit ORKA, që e udhëheq Ron Gjinovci, një student i dobët, që nuk e ka përfunduar as fakultetin, sipas informacioneve tona, dhe i jepet forcë e hapësirë të kritikojë stafin akademik dhe tërë Universitetin dhe opinioni i tij fuqizohet nga Ministri. Çdo gjë në arsim duhet vlerësuar nga MASHT dhe nëse është nevoja nga Akademia e Shkencave e jo nga OJQ-të, që nuk dihet kush e me çfarë qëllimi i financon.
7. Vendimi i Ministrit për emërimin e Komisionit për Zhvillimin e Strategjisë Nacionale për Arsimin e Lartë të Kosovës. Strategjia nationale e kryetar një ndërkombëtarë bashkë me 5 ndërkombëtarë të tjera e me asnjë anëtarë të Akademisë së Shkencave e pa rektorin e UP apo të Universiteteve tjera, pa përfaqësuesin e SBASHK-ut, që do të ishte nga Universiteti, e me Ron Gjinovicin.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

8. Largimi i përnjëhershëm i më shumë se 20 udhëheqësve të departamenteve. Jemi kundër formës së largimit. Këta njerëz kanë punuar me vite dhe janë trajnuar për detyrat e tyre dhe të rinjtë në këto detyra me përgjegjësi vështirë se do të mund të kontribuojnë mjaftueshëm, sepse nuk e njohin natyrën e punës dhe nuk e dinë se deri ku kanë arritur punët dhe proceset. 10. 10..
9. Kërkojmë që Ministri të jetë në komunikim të vazhdueshëm me njerëz që janë të angazhuar në procesin arsimor e jo të bazohet në praktika të shteteve tjera sepse "rrobat që na i presin e qepin të tjerët nuk na bijnë neve.
10. Ministër në mandatin tuaj po myllen shkolla, që nuk ka ndodhur deri tani. Është mirë që ju të mobilizoni mësimdhënësit me fjalë plot entuziazëm për angazhime të shtuara e jo duke bërë presion mbi ta.
11. Lidhur me Udhëzimin Administrativ 10/2018, as që kanë filluar përgatitjet që të punësuarve në arsim me baqellor me 180 kredi, që janë pranuar dikur në mënyrë të rregullt në punë, t'u mundësohet ngritja profesionale pa shkëputje nga puna e në mënyrë të organizuar.
12. Trajnimet- Ne po organizojmë trajnime me mjetet tona, edhe pse kemi buxhet modest, në

mënyrë që t'u ndihmojmë mësimdhënësve të plotësojnë 100 orët e kërkua të licencë të karrierës. Të shihen mundësitat për trajnime sepse mësimdhënësve u kërkohen 100 orë trajnim, prej të cilave 70 nga sfera profesionale.

13. Më datën 10 nëntor SBASHK dhe GIZ organizon Konferencën "Komuniteti i të mësuarit së bashku" e në shërbim të ngritjes së cilësisë në arsim. Do të ishte mirë të ishit në këtë Konferencë edhe ju i nderuar Ministër, se paku në pjesën hyrëse e pastaj ta caktoni dikë nga MASHT që ta përcjellë tërë Konferencën.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë kërkuar nga Ministri edhe që të respektojë personalitetin e mësimdhënësve dhe t'i mbrojë ata në publik dhe nga sulmet e vazhdueshme ndaj figurës dhe personalitetit të tyre. Nëse duhen kritikuar këtë gjë le ta bëj Ministri në takimet me ta dhe me drejtorët. Ministri Bytyqi është shprehur se për shumë nga këto çështje është angazhuar dhe bashkë me Zv/Kryeministrin Limaj janë zotuar se bashkëpunimi me SBASHK e në shërbim të punëtorëve të arsimit do të jetë edhe më i mirë në të ardhmen.

SBASHK për Ditën Ndërkombëtare të Mësuesit

## Mësuesit dhe arsimi në tërësi kudo në botë para sfidave të shumta



Me një konferencë për mediet dhe me aktivitete të shumta nëpër shkollat e Kosovës, SBASHK-u ka shënuar 5 tetorin- Ditën Botërore të Mësuesve.

Një aktivitet i qëlluar e me veteranët e arsimit është mbajtur për ndër të 5 tetorit në Shkollën e gjelbër në

Prishtinë. Në këtë aktivitet kulturor kanë marrë pjesë edhe disa nga përfaqësuesit e SBASHK-ut të kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, i cili përgëzojë drejtoreshën, mësimdhënësit dhe nxënësit e kësaj vatre arsimore për këtë veprimtarit të qëlluar e shumë domethënëse.



Në konferencën për medie kryetari i SBASHK-ut ua ka uruar mësimdhënësve të Kosovës dhe tërë botës



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

5 tetorin ditën ndërkombejtare të mësuesit. Për të theksuar pastaj se mësimdhënësit janë autoriteti moral për nxënësit, të cilët formojnë vlerat morale dhe ndjenjat shpirtërore.

“ Ju u mësoni nxënësit të mendojnë në mënyrë të pavarur, të marrin vendime dhe të marrin përgjegjësi për zgjedhjen e tyre, të jenë qytetarë të denjë të vendit tonë. Të jesh mësues eshtë punë e vështirë, lumturi e madhe dhe përgjegjësi e madhe. Ne ju përgëzozjmë në ditën tuaj profesionale! Ne ju dëshirojmë zbatimin e planeve tuaja krijuar, punën e frytshme dhe suksesin profesional. Shëndetin e mirë për ju dhe familjet tuaja! Gëzuar Ditën Botërore të Mësuesit!

Ju e dini se viteve të tjera kemi organizuar Konferenca me tema të caktuara për nder të 5 tectorit. Këtë vit po veprojmë ndryshe sepse konsiderojmë se në shtetin tonë po organizohen shumë Konferenca me tema shumë të rëndësishme, por çdo gjë po përfundon me ca konkluzione, të cilat rrallë po jetësohen, kështu që ne 5 tectorin do ta shënojmë me këtë konferencë me ju dhe me një varg aktivitetesh nëpër komuna e me mësimdhënës, qoftë duke u takuar me tanë mënyrë që të veprojmë bashkërisht, qoftë duke organizuar trajnime, që eshtë kërkuesë e vetë punëtorëve të arsimit. Pra kemi zgjedhur rrugën më pak fjalë e më shumë punë e angazhimë konkrete gjatë gjithë muajit tector, por edhe në muajit tjerë.



Në këtë tector, e për nder të ditës ndërkombejtare të mësuesit kudo në botë Internacionalja Botërore e Arsimit ka paraparë që aktivitetet të jenë të orientuara në moton " E drejta e mësimdhënies- e drejtë vetëm e mësuesit" , që ka për qëllim që të krijohen kushte pune që mësuesi të ndjehet I lirë e jo në presion të të tjerëve në misionin e tij human të arsimimit e edukimit të brezave. Jo rrallë në Kosovë e në shumë vende të botës të tjerët vendosin për arsimin pa qenë I përfshire vetë mësuesi. Për arsimin nuk mund të vendoset nga kabinetet e zyre dhe pa mësuesin. Kudo në botë janë shtuar angazhimet në mbrojtje të personalitetit dhe figurës së mësuesit. Janë angazhimet në mbrojtje të mësuesit nga ndërhyrjet e ndryshme dhe sidomos nga

politika. Shkolla duhet të jetë e mësimdhënësve dhe e nxënësve , kurse të tjerët duhet të ndihmojnë e jo të pengojnë angazhimet dhe përkushtimin për arritje të reja.

Nëse bëjmë një analizë të aktualitetit në arsim do të themi se edhe ky 5 tector arsimin në Kosovë e gjen duke u përballur me sfida të shumta. Deklarimi i institucioneve se arsimi eshtë prioritet as sot e kësaj dite nuk eshtë kthyer në vepër. Eshtë bërë shumë pak që të përmirësohen kushtet e punës në institucionet arsimore. Shkollat mbeten të pa përgatitura përkérkesat e shekullit 21 dhe mësuesi me shkumës e shpuzë e ka të vështirë të plasojë si duhet dijet e tij te nxënësit.

SBASHK-u vazhdimisht ka ofruar ide që lehtë mund të realizohen në shërbim të arsimit më të mirë. Kemi kërkuar të ketë buxhet më të madh për arsimin në mënyrë që shkollat të jenë të pajisura me kabinete e me mjete bashkëkohore të punës, kemi kërkuar që punëtorët e sëmurë rëndë të pensionohen duke u dhënë pensione të dinjitetshme dhe në vend të tyre të angazhohen mësimdhënësit praktikantë, kemi kërkuar që punëtorëve të arsimit t'u mundësohet pensionim I parakohshëm. Këto ide janë lavdëruar , por institucionet nuk kanë bërë gjë në këtë drejtim” Kryetari Jasharaj ka kujtuar se SBASHK-u edhe në këtë 5 tector eshtë duke u përballur me sfida.” Janë bërë e po bëhen angazhime të jashtëzakonshme në realizimin e kërkeseve legitime të anëtarësisë, sidomos lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip përvitet e 90-ta dhe përrorrigimet në Projektligjin përvitet. Këto dy kërkesa janë në proces dhe urojmë që Komisionet parlamentare të veprojnë drejt dështimit përfillin kërkuesat tonë të argumentuara. SBASHK-u eshtë duke përcjellë me kujdes punën e komisioneve gjegjëse parlamentare dhe po zhvillon takime në vazhdimësi me anëtarët e këtyre komisioneve.



Ne i gëzohemi arritjeve përmes dialogut, por çdo herë mbetet i hapur opsioni tjetër, pra ai I veprimeve sindikale nëse institucionet nuk bëjnë si duhet punën e tyre në relacion me kërkuesat tonë legitime” ka shtuar Jasharaj për t’ju përgjigjur pastaj edhe pyetjeve të medieve.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Vazhdojnë aktivitetet e SBASHK-ut me anëtarësinë nëpër komuna

## Përkushtim e angazhime edhe në ditët e vikendit



SBASHK-u, krashtë angazhimeve të vazhdueshme në realizimin e kërkesave legitime të punëtorëve të arsimit, është i përkushtuar të vazhdojë në realizmin e kërkesave të anëtarësisë për realizimin me sukses të trajnimeve, që janë licencuar nga MASHT.

Në realizim të këtij objektivi është realizuar trajnimi për forcimin e kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social më punëtorë të arsimit në fshatin Pozharan dhe në vetë qytezën e Vitisë.



Për të qenë trajnimi i suksesshëm dhe për të marrë njohuri të mjaftueshme pjesëmarrësit, SBASHK-u ka ndihmuar duke siguruar kontributin e trajnerit Safet Beqiri, që është ndihmuar nga trajnerët e SBASHK-ut Besa Krasniqi, nënkyetarja Vjollca Shala dhe kryetari i Kuvendit të Arsimit Fillor në kudër të SBASHK-ut, Blerim Mehmeti.



Ky aktivitet është zhvilluar edhe në ditët e vikendit dhe për të bashkëbiseduar me pjesëmarrësit e këtij trajnimi të dielën i ka vizituar ata kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga nënkyetari i BSPK-së, prof. dr. Atdhe Hykolli dhe juristin në SBASHK, Blendor Shatri. Ata janë ndjerë mirë kur pjesëmarrësit e trajnimeve kanë lavdëruar përkushtimin e trajnerëve dhe kanë falënderuar SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe kryetarin e Kuvendit të SAF e SAM në këtë komunë, Kemajl Bislimi për punën e palodhshme që ai bashkë me kryesinë është duke bërë në shërbim të anëtarësisë këtu. Ishte ky moment i mirë edhe për një komunikim të lehtë përmes bashkëbisedave dhe Jasharaj, Hykolli e Shatri u janë përgjigjur shumë pyetjeve që kishin të bënin me aktualitetin në arsim dhe me fillimin e procesit të vlerësimit të punës së mësimdhënësve duke i vizituar ata në klasë gjatë punës edukative e arsimore. Vlen të përmendet se pjesëmarrësit në këtë trajnim i ka vizituar edhe e përfaqësuesi i DKA-së në Viti, Zijadin Ahmeti, i cili ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut dhe ka kujtuar se drejtoria e arsimit në këtë komunë ka bashkëpunim korrekt me kryetarin, kryesinë dhe veprimtarët tjerë të Kuvendit të Sindikatës së SAF e SAM të kësaj komune.



Po të dielën përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë shkuar në Kamenicë dhe bashkë me kryetarin e Kuvendit të SAF e SAM të kësaj komune janë takuar me pjesëmarrësit e trajnimit për dialogun social, që është mbajtur para pak ditësh këtu. Në këtë solemnitet rasti janë ndarë certifikatat për këtë trajnim të licencuar me numrin e caktuar të orëve që punëtorëve arsimor këtu do t'ju numërohen për të arritur të numri i duhur për licencat tani dhe avancimin në karrierë në të ardhmen.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Vazhdojnë aktivitetet dhe bashkëbisedat me anëtarësinë

## Interesim i shtuar për trajnimet e licencuara të SBASHK-ut



Në shumë nga komunat e Kosovës është duke vazhduar gjatë vikendeve trajnimi për forcimin e kapaciteteve për Dialogun SSocial, por kohëve të fundit ka zgjuar interesimin e anëtarësisë edhe trajnimi tjetër i licencuar e që ka të bëj me udhëheqjen dhe menaxhimin e institucioneve të Arsimit Parauniversitar. Ishte Lipjani komuna e radhës që mori iniciativën për një aktivitetet të tillë. Kryetari i SAF e SAM të kësaj komune Emrush Ahmeti në koordinim me organet udhëheqëse të SBASHK-ut kanë organizuar në ditët e vikendit këtë aktivitet duke përfshirë udhëheqësit sindikal nga shkollat e kësaj komune pikërisht me temën kyçë të fitimit të aftësive e përvojave për udhëheqjen në sindikatë dhe në institucionet arsimore. Ky aktivitet është mbajtur me mjtet financiare të nivelist sindikal komunat. Trajneri Alban Zeneli, është ndihmuar nga kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri për të shtjelluar temat që kanë të bëjnë pikërisht me udhëheqjen dhe menaxhimin.



Këtë aktivitete e ka parë nga afër edhe drejtori i DKA-së së Lipjanit, Rasim Hasani, i cili ka lavdëruar bashkëpunimin me sindikatën e arsimit. Edhe kryetari

i SBASHK-ut ka përshëndetur z Hasanin dhe e ka përshëndetur angazhimin e tij që të ndihmojë brenda mundësive mbajtjen e këtij aktiviteti të qëlluar sindikal.

Kryetari i Kuvendit të SAF e SAM për Lipjnain, Emrush Ahmeti ka bërë në fillim një përshkrim të aktiviteteve sindikale në komunë e tij dhe ka falënderuar edhe DKA-në e Lipjanit që ka pasur mirëkuptim për këtë aktivitet dhe ka ndihmuar duke u dhënë në dispozicion një autobus për të arritur pjesëmarrësit në këtë trajnim. Kryetari i SBASHK-ut pas kësaj ka shpalosur disa nga aktivitetet aktuale të SBASHK-ut duke lavdëruar angazhimet dhe unitetin sindikal në Lipjna dhe në tërë Kosovën.



Trajneri Alban Zeneli me përkushtim ka bërë shtjellimin e temave dhe trajnimi ka fituar në dinamikë ngase ai shumë çështje i ka shtruar në mënyrë të bashkëbisedës me pjesëmarrësit.

Po ashtu gjatë këtij vikendi është mbajtur edhe trajnimi në formë te konsultimeve me kryetarë të sindikatave njësive akademike të Universiteteve të Kosovës lidhur me dialogun social. Pjesë e këtij aktiviteti ishin edhe prof. Dr. Atdhe Hykolli me menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri. Gjatë këtij aktiviteti sindikal janë ngritur shumë çështje dhe janë dhënë ide lidhur me zgjidhjen e çështjeve të ngritura.

Duke u bazuar në kërkesat e shtuara për trajnime kudo në komunat e Kosovës, SBASHK-u ka shtuar mobilizimin në këtë sferë me qëllim që t'u përgjigjet këtyre kërkesave të anëtarësisë.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Vërtetë nuk ka pushim as në vikende

Duke iu përgjigjur kërkesave të anëtarësisë për trajnime përfaqësuesit e SBASHK-ut bashkë me trajnerët kanë vazhduar këtë aktivitet edhe të shtunë e të dielën e 27 dhe 28 titorit duke u gjendur në Lipjan e Viti. Në Lipjan trajneri Alban Zeneli ka përmbyllur me sukses trajnimin për udhëheqje dhe menaxhim të institucioneve të Arsimit Parauniversitar me kryetarë shoqatash sindikale të shkollave të kësaj komune. Po gjatë këtij vikendi trajnerët Besa Hoxha Krasniqi dhe

Safet Beqirie Blendor Shatri kanë vazhduar me trajnimet me mësimdhënës të shkollave të Vitisë lidhur me dialogun social. Këtë veprimtari e kanë parë nga afër edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj e menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, të cilët u janë përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve në trajnime e që kishin të bënин me aktualitetin në arsim dhe për angazhimet dhe sfidat e SBASHK-ut në përpjekje për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë.

## Kongres i suksesshëm i Sindikatës së Pavarur të Arsimit Shqiptar



Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë ka mbajtur Kongresin 7 për të bërë një analizë të aktiviteteve e arritjeve dhe për të përgatitur strategjinë e angazhimeve në 5 vitet e ardhshme. Në këtë ngjarje të veçantë për arsimin shqiptar ka marrë pjesë edhe delegacioni i SBASHK-ut bashkë me delegacione të shumta të sindikatave të nga shtetet e Ballkanit, Evropës e botës. Punimet e Kongresit i ka përcjellë nga afër edhe znj. Kristin, drejtore e përgjithshme e Komitetit të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës.



Kryetari i SPASH-it, Nevruz Kapetelli në hapje të Kongresit ka përshëndetur delegacionet pjesëmarrëse e pastaj ka shpalosur një pjesë të aktiviteteve e arritjeve për 5 vitet e kaluara. Pas kësaj mysafirët kanë përshëndetur Kongresin në emër të sindikatave që përfaqësonin. Kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar SPASH-in për përkushtimin dhe angazhimet në mbrojtje të kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe ka shtuar se punëtorët e arsimit, por edhe populli i Kosovës nuk e harron kurrë përkrahjen dhe pritjen vëllazërore që po dëboheshin dhunshëm nga pushtuesi serb.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pas kësaj kryetari Jasharaj është shprehur:" Nevruzit dhe SPASH-it i solla një dhuratë modeste në emër të punëtorëve të arsimit. Kjo dhuratë është harta e Kosovës e punuar me gurët e Trepçës që është krenaria jonë. Këta gurë sot kanë edhe një domethënie tjetër se duhet të jemi të fortë si guri në përpjekjet për arritjen e objektivave tona.



Pas fjalëve përrshëndetëse nikoqiri u dha kënaqësinë mysafirëve që të vizitojnë qytetin e Beratit e pastaj të jenë edhe në një darkë solemne në qytetin e bukur të

Durrësit. Kjo darkë solemne ishte moment i mirë që mysafirët dhe veprimtarët sindikalë nga Shqipëria të përgëzojnë z. Nevruz Kaptellin për besimin që Kongresi i kishte dhënë që ta udhëheq edhe për 5 vite SPASH-in.



Vlen të përmendet se delegacioni i SBASHK-ut në Tiranë ka zhvilluar takime të ndara me shuam nga delegacionet pjesëmarrëse në Kongres, të cilët kanë shprehur gatishmërinë që të forcojnë bashkëpunimin me SBASHK-un.